



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 239/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.04.2019 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-05550-01-29-2019, me objekt: “Shërbim me roje private”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 11.02.2019, nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Çullhaj” shpk procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Eurogjici Security” shpk.
Rruga “Adem Jashari”, Lagja 8, H.10, Ap.3, Tiranë.

“Çullhaj” sh.p.k.
Rruga “Ilia Shyti”, Nd.20, H0.1, Njësia bashkiake nr.3, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë.
Rruga “Aleksandër Moisiu”, nr.80, Tiranë.

Subjekte të Interesuara:

“A 2000” sh.p.k.
Rruga: “Hamit Shijaku”, 24/3, Tiranë

“International Security Albania” sh.p.k
Blv “Zogu 1”, Pall. Nr.55/1, Shk.1, Kati.2, Ap.9 (përballë Cirkut Kombëtar), Tiranë.

“Dea Security” shpk
Adresa: Rruga “Ndre Mjeda”, Qendra Polifunkionale, kati i I-rë, Tiranë.

“Toni Security” shpk.
Rruga “Lidhja e Prizrenit”, Njësia bashkiake nr.5 Pall 10/1, kati i parë Tiranë.

“Siguria” shpk
Rruga “Frederik Shiroka”, Njësia Bashkiake Nr.7, Godina nr.14 (Ish-Shtëpia Botuese “8-Nëntori”), Tiranë.

“Kevenjo” shpk
Adresa: Lagjia e Re, Peshkopi, Dibër.

“Leksi Security” shpk
Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga e Barrikadave, Pallati Albtoronto, Hyrja 3, Kati 3.

“Mandi 2K” shpk
Adresa: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Nikolla Tupe”, Pallati Verdhë 8-katësh, Kati i parë, Tiranë.

“Myrto Security” sh.p.k
Adresa: Lagjia “Kastriot”, Rruga “Brigada e 11 Sulmuese” Godina e Albtelecom, Fier.

“Nazeri 2000” shpk
Adresa: Rruga “Kavajës”, Qendra Condor, kati II, Tiranë.

“Res 03” shpk
Adresa: Lagjja Minatori, Diber Bulqize.

“Snajper Security” shpk
Adresa: Lagjia “Pjetër Budi”, rrruga “Kont Uran”, ngjitur me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Mat.

“Start 2000” shpk
Adresa: Njesia Bashkiake nr.2, rrruga “Budi”, Nr.19, Tiranë.

“Trezhnjeva” shpk
Adresa: Njësia Administrative nr. 7, ish Fusha e Aviacionit, Godina nr. 22, Pallati nr. 9, Ap 9, Tiranë.

“Conspiration-Metropol” sh.p.k

Adresa: Njesia Bashkiake Nr.9, Rruga Haxhi Dalliu, Pallat i Ri, Kati 1,
Përbri Prokurorise se Tiranes, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë interes për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të bazuar në pikën 1 të nenit 63 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimes

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.01.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-05550-01-29-2019, me objekt: “*Shërbim me roje private*”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 11.02.2019, nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

II.2. Në datën 11.02.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 25.02.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Kapital Security” sh.p.k.	6021432.00 lekë	skualifikuar
2. “Arbana” sh.a.	6862992.56 lekë	skualifikuar
3. “Arb Securty Group” sh.p.k.	6862992.56 lekë	skualifikuar
4. “A 2000” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
5. “Conspiracy Metropol” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
6. “Dea Security” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
7. “International Security Albania” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
8. “Kevenjo” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
9. “Leksi Security” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
10. “Mandi 2K” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
11. “Myrto Security” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
12. “Nazeri 2000” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
13. “Res 03” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
14. “Siguria” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
15. “S.A.S” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
16. “Snajper Security” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
17. “Start 2000” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
18. “Toni Security” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
19. “Trezhnjeva” sh.p.k.	6863992.76 lekë	kualifikuar
20. “Dajti” sh.p.k.	6863992.76 lekë	skualifikuar
21. “Ballazhi” sh.p.k.	6863992.76 lekë	skualifikuar
22. “Çullhaj” sh.p.k.	6863992.76 lekë	skualifikuar
23. “Eurogjici Security” sh.p.k.	6863992.76 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 25.02.2019, operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk është njoftuar elektronikisht lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me arsyetimin si më poshtë:

“Nuk plotëson kriterin tek kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3 kapaciteti teknik nënpika 3”

II.5. Operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk, në datën 27.02.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

[...]

Oferta juar OFFER-6087/08022019 për tenderin REF-05550-01-29-2019 “Shërbim me roje private” është refuzuar.

REASONS:

- Nuk plotëson kriterin tek kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3 kapaciteti teknik nënpika 3.

Ndodhur në këto kushte me të drejtën që na njeh ligji shoqëria jonë ankohet me arsyetimin si më poshtë vijon:

Së pari, autoriteti kontraktor ka parashikuar si arsye për skualifikimin e ofertës së shoqërisë sonë: “Nuk plotëson kriterin tek kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3 kapaciteti teknik nënpika 3 “

Në kriteret e veçanta të kualifikimit në pikën 2.3 “Kapaciteti Teknik” nënpika 3 autoriteti kontraktor ka kërkuar: “Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik. Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.”.

Kundërshtojmë me forcë këtë arsye abuzive skualifikimi duke argumentuar si më poshtë:

Së pari, autoriteti kontraktor ka arsyetuar se oferta ekonomike e shoqërisë sonë refuzohet sepse: “Nuk plotëson kriterin tek kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3 kapaciteti teknik nënpika 3.”.

Në kriteret kualifikuese autoriteti kontraktor në DST-në e procedurës së prokurimit ka kërkuar: “Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik. Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.”.

Në arsyen e skualifikimit të paraqitur nga autoriteti kontraktor nuk qartësohet arsyeja e skualifikimit. Autoritetet kontraktore janë të detyruara që konform ligjit të LPP-së të sqarojnë operatorët ekonomikë mbi arsyet pse ofertat e tyre nuk janë në përputhje me kriteret kualifikuese. Bëjmë me dije se operatori ynë ekonomik ka paraqitur në tender vërtetimin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, vërtetim ky nr.143/39 prot, datë 24.01.2019.

Në rast se autoriteti kontraktor ka skualifikuar ofertën e shoqërisë sonë mbështetur në masën administrative të mara prej drejtuesit teknik të cilat ndodhen në proces gjykimi kundërshtojmë si më poshtë:

1. Autoriteti kontraktor me keqdashje ka marrë në konsideratë një masë administrative e cila është në proces gjyqësor. Bëjmë me dije se e shohim të pamundur që një jurist i KVO-së pranë autoritetit kontraktor mund të ketë konfirmuar apo iniciuar një arsye të tillë skualifikimi. Na lind e drejta të dyshojmë se KVO-ja nuk do jetë ngritur prej autoritetit kontraktor sipas standarteve që detyron ligji, ku një anetëar i KVO-së të jetë ekspert i fushës mundesisht jurist, çka do e bënte vendimin e kësaj KVO-je absolutisht të pavlefshëm në kushtet kur është shkelur procedura e emërimit të anetarëve të saj. Më konkretisht në rastin specifik për të kundërshtuar këtë arsye skualifikimi po i referohemi normave legjislative sipas piramidës së fuqisë së tyre ligjore, duke prekur në sejcilën prej tyre nenin që KVO-ja e ka shkelur me dashje ose nga padijenja.

- a. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 6.
- b. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 30.
- c. Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit, neni 9.
- d. Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, neni 11.
- e. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike e vitit, neni 14/2.
- f. Karta e Lirive Themelore e Bashkimit Europian, neni 48/1.
- g. Vendimin nr. 4, datë. 27.02.2004, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
- h. Vendimin nr. 9, datë 28.04.2004, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
- i. Vendimin nr. 23, datë 23.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
- j. Kodi i Procedurës Administrative, Neni 23.

Etj.

Masa administrative është e pezulluar ashtu siç lehtësisht e thotë dhe neni 23 i Kodit të Procedurës Administrative derisa Gjykata të shprehet në lidhje me të me një vendim të formës së prerë.

Pra çka kemi sqaruar më lartë është e qartë që pretendimi i autoritetit kontraktor në lidhje me këtë arsye skualifikimi nuk qëndron.

II. Bëjmë me dije se vërtetimi i performancës së shoqërisë sonë është paraqitur në formën dhe me përmbajtjen e kërkuar nga autoriteti kontraktor në këtë procedurë prokurimi. Kundërshtojmë këtë arsye abuzive duke u mbështetur në dy pika si më poshtë:

1. Në kriteret kualifikuese nuk është kërkuar në asnjë moment që vërtetimi i performancës mos të ketë shkelje. Autoriteti kontraktor nuk mund të vlerësojë një ofertë ekonomike jashtë kriterëve kualifikuese. Në pikën 3, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, (ndryshuar) është përcaktuar se: “3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4, të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”.

Pra ajo çka na detyron ligji është që ofertat do të vlerësohen vetëm nëse janë në përputhje me njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit dhe vlerësim jashtë kërkesave të parashikuara në dokumentat e tenderit kurrësi nuk mund të bëhet.

2. Bëjmë të qartë se vërtetimi i performancës ka dalë me një shkelje të tillë, si pasojë e masave administrative të marra ndaj drejtuesit teknik z.Luan Shehu. Siç ju sqaruam dhe lartë përderisa masat administrative janë në proces gjyqësor asnjë organ nuk mund të shprehet për to derisa Gjykata të shprehet me vendim të formës së prerë. Në këto kushte ska sesi autoriteti kontraktor të vlerësojë të mirëqënë një vlerësim i cili është në shqyrtim gjyqësor dhe gjykata ende nuk është shprehur në lidhje me të.

Përsa më sipër pretendimi i autoriteti kontraktor nuk qëndron.

Përfundimisht, kërkojmë,

- a) Anullimin e vendimit të autoriteti kontraktor për skualifikimin e ofertës së shoqërisë sonë.
- b) Pezullimin e procedurës deri në shqyrtimin e plotë të ankesës;
- c) Kualikimin e ofertës së shoqërisë sonë.

II.6. Me anë të shkresës nr.95/16 prot., datë 06.03.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar atë.

II.7. Në datën 11.03.2019 operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 25.02.2019, operatori ekonomik “Çullhaj” shpk është njoftuar elektronikisht lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me arsyetimin si më poshtë:

“Vërtetimi i performancës lëshuar nga D.V.P nuk mbulon gjithë periudhën e vitit 2018”

II.9. Operatori ekonomik “Çullhaj” shpk, në datën 27.02.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

Në datën 11.02.2019, u zhvillua procedura e prokurimit nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë “Ruajtja e godinës me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”.

Më datë 25.02.2019 u njohëm nëpërmjet sistemit elektronik me klasifikimin ku shoqëria “Çullhaj” shpk rezulton e skualifikuar me motivacionin më absurd, tendencioz dhe selektiv se “Vërtetimi i performancës lëshuar nga D.V.P nuk mbulon gjithë periudhën e vitit 2018”.

Së pari: Autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit, saktësisht “Kriteret e Veçanta për Kualifikim”, “Kapaciteti Teknik”, pika 3, citohet: “Dokumenti i Performancës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik. Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik”

Për përmbushjen e kësaj kërkesë shoqëria “Çullhaj” shpk ka paraqitur Vërtetimi i performancës lëshuar nga DVP-ja më datën 08.02.2019 ne pikeën IX, citon se: Shoqëria “Çullhaj” shpk ka shlyer të gjitha detyrimet financiare për vitin 2018 ndaj DVP-së Tiranë dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.

Pra KVO-ja e ngritur nga autoriteti kontraktor me pretendimin (“Vërtetimi i performancës lëshuar nga DVP nuk mbulon gjithë periudhën e vitit 2018”) ka skualifikuar shoqërinë tonë me pretendime të pakërkuara dhe të shkruara në dokumentat standarte të tenderit. Ky skualifikim i shoqërisë tonë përbën një akt abuziv dhe diskriminues.

Bazuar në Neni 53/3, autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4, të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

- *Kërkojmë pezullimin e procedurës së tenderit derisa të shqyrtohet ankesa e shoqërisë sonë.*
- *Kërkojmë kualifikim e operatorit ekonomik “Çullhaj” shpk pasi ka paraqitur të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar nga autoriteti kontraktor.*

II.10. Me anë të shkresës nr.95/14 prot., datë 06.03.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar atë.

II.11. Në datën 12.03.2019 operatori ekonomik “Çullhaj” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Nëpërmjet shkresës nr. 95/21 prot., datë 25.03.2019, protokolluar me tonën në datën 25.03.2019 me objekt “*Dërgim Informacioni*” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Eurogjici Security*” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Nuk plotëson kriterin tek kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3 kapaciteti teknik nënpika 3*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*” pika 2.3.3 e “*Kapacitetit teknik*” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

3. Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “*Eurogjici Security*” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Vërtetim nr.143/39 prot, datë 24.01.2019 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ku ndër të tjera përcaktohet si vijon: Ndaj drejtuesit teknik Z.Luan Shehu me vendim nr.722/119 datë 27.07.2018 është dhënë masë administrative gjore në vlerën 30.000 lekë të cilën e ka shlyer. Ndaj drejtuesit teknik Z.Luan Shehu me vendim nr.722/153 datë 09.10..2018 është dhënë masë*

administrative gjobë në vlerën 50.000 lekë të cilën nuk e ka paguar. Bazuar në vërtetimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me nr.extra datë 23.11.2018 ku theksohet se subjekti shpsf Eurogjici Security shpk ka ankimuar vendimin nr.722/19 datë 27.07.2018 dhe vendimin nr.722/153 datë 09.10.2018 duke kërkuar pavlefshmërinë absolute të këtyre vendimeve.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”*.

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 28, pika 5, gërmat a-ç, parashikohet si më poshtë: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*.

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

III.1.6. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik *“Eurogjici Security”* shpk, për vërtetimin e lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë, Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se ky dokument jep informacion të plotë lidhur me faktin se ky operator ekonomik gjatë aktivitetit të tij dhe konkretisht drejtuesi teknik ka marrë 2 (dy) masa administrative të llojit gjobë, gjatë ushtrimit të aktivitetit në vitin 2018. Në sa më sipër, si dhe duke patur parasysh kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues *“Eurogjici Security”* shpk, nuk e ka përmbushur kërkesën e autoritetit kontraktor, pasi ka masa administrative.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici Security” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Çullhaj” shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së dorëzuar prej tij me arsyen se: “Vërtetimi i performancës lëshuar nga D.V.P nuk mbulon gjithë periudhën e vitit 2018”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Nga shqyrtimi i Shtojcës.8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi konstatohet se nuk parashikohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin vërtetim performance lëshuar nga D.V.P që të mbulojë të gjithë periudhën e vitit 2018.

III.2.2.. Në nenin 46 pika 1 gërma “c” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.3. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.2.4. Në nenin 28, pika 5 “Kontratat e Shërbimeve” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se “5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktorkërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) “Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”33.”.

III.2.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me

kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përputhen me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik thekson pozitën e tij të veçantë si një organ *quazi gjyqësor* dhe si i tillë në vendimarrjen e tij bazohet në fakt, prova dhe ligj. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, i cili parashikon se “*Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*”, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Në rastin konkret, KPP konstaton se referuar kritereve të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor në drejtim të plotësimit kapaciteteve teknike ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik detyrimin për paraqitjen e Dokumentit të Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik dhe për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit, kritereve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në asnjë rast që ofertuesit të paraqesin vërtetim performance lëshuar nga drejtoria vendore e policisë që të mbulojë të gjithë vitin 2018. KPP gjykon se në cilësinë e një organi *quazi gjyqësor*, në vendimarrjen e tij, ky i fundit i referohet parimeve të së drejtës *Judicis est judicare secundum allegata et probate (organi vendos në bazë të fakteve dhe provave të administruara në proces)*. KPP nuk mund të gjykojë mbi plotësimin e kritereve të veçanta të kualifikimit mbi kritere të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Çullhaj” shpk, për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-05550-01-29-2019, me objekt: “*Shërbim me roje private*”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 11.02.2019, nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Çullhaj” shpk, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
 6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Çullhaj” shpk.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 432 Protokolli Nr. 440 Protokolli
Datë 11.03.2019 Datë 12.03.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

